



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosova



MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE AND TECHNOLOGY


MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKE I TEHNOLOGIJU

QENDRA E STUDENTËVE
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS
PRISHTINË

STUDENTS' CENTER OF
UNIVERSITY OF PRISHTINA
PRISHTINA

STUDENTSKI CENTAR
UNIVERSITETA PRISHTINE
PRISHTINA

Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel.: +381 (0) 38/223-951, +381 (0) 38/225-976
www.qs.rks-gov.net



Duke u bazuar në nenin 15.2.3. të Statutit të Qendrës se Studentëve, si dhe bazuar në Rregulloren për sistematizim të brendshëm të Qendrës së studentëve nr, 13/14, Drejtori i përgjithshëm i Qendrës se Studentëve miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SE SPORTEVE "1 TETORI" NË PRISHTINË

Neni 1

1.1 Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "1 Tetori" në Prishtinë për aktivitetet sportive, manifestimet e ndryshme të kulturës e rekreacionit, tubimeve tjera të shoqatave dhe partive politike.

Neni 2

2.1 Subjektet e interesuara për shfrytëzimin e Palestrës sportive duhet që së paku 7 (shtatë) ditë para ditës së organizimit të manifestimit, tubimit, apo aktivitetit sportiv dhe kulturor, t'i drejtohen me kërkesë përgjegjësit të palestrës, ose DSKSR-it , të cilët janë të obliguar që të kthejnë përgjigjen brenda 48 orëve.

2.2 Studentët e Universitetit të Prishtinës, që kanë kalendrar të rregullt të garimit do të shfrytëzojnë Palestrën e sporteve në bazë të një orari të rregullt të rregulluar nga përgjegjësi i palestrës në bashkëveprim me përfaqësuesit e studentëve dhe të vërtetuara nga DSKS.

Neni 3

3.1 Të gjitha klubet sportive që zhvillojnë veprimtarinë e tyre , mund ta shfrytëzojnë Palestrën sportive për stërvitje dhe garim në kuadër në përputhje me këtë rregullore.

- a) Për stërvitje pa pagesë vetëm studentët e UP-së, nga ora 08:00-16:00 (e hene – e premte)
- b) Për zhvillimin e ndeshjeve mes klubeve të ndryshme kosovare, çmimi për ndeshje – 100 €.
- c) Palestra e Sporteve mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të tjera të ndryshme kulturo-sportive duke paguar:



1. Aktivitete rekreative- sportive 20 €/h, kurse klubet dhe shkollat sportive 10 €/h.
2. Aktivitete dhe ngjarje komerciale (për një orë) 25 €.
3. Aktivitete dhe ngjarje jo komerciale(për një orë) 20 €.
4. Aktivitetet politike(për një orë) 100 €.
- 5.Rezervimi i sallës për përgatitje teknike 400 € për tërë ditën, kurse rezervimi i sallës për mbajtje te aktiviteteve të tjera si panaire, ceremoni diplomimi, koncerte etj. Çmimi është 500 € për 24 orë.

Neni 5

Transmetimi i ngjarjeve në Palestër nga Kompanitë televizive në rast se nuk janë ftuar nga Subjekti që organizon aktivitetin, paguajnë tarifë fikse 100€ për transmetim

Neni 6

Reklamat lëvizëse të Sponsorëve të klubeve mund të ekspozohen vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre .

Neni 7

7.1 Prej të gjitha obligimeve financiare lirohen organizimet Shtetërore që bënë Komuna për Festa Shtetërore e Kombëtare, qofshin ato me karakter kulturor apo sportiv, por nëse organizatori nuk përfiton nga shitja e biletave.

7.2 Me ndonjë arsyeshmëri të veçantë nga pagesa mund të lirohet ndonjë subjekt (Shoqatat e dalura nga Lufta ,Personat me aftësi të veçanta).Por pas aprovimit nga Drejtoria e QS-së.

Neni 8

8. Në Palestrën e Sporteve ndalohet bartja e armëve dhe mjeteve të tjera eksplozive . pirja e duhanit, dhe alkooli ,dhe personat që thyejnë këtë rregull largohen nga Palestra e Sporteve nga zyrtarët për siguri.

Neni 9

9.1. Dëmet e regjistruara gjatë ushtrimeve ose lojërave zyrtare vlerësohen nga një Komision prej 3-tre anëtarëve që themelohet nga Drejtoria e QS-së. dhe ky Komision përgatitë Procesverbal të posaçëm për dëmet e regjistruara.

9.2 Dëmet e regjistruara nga Komisioni i formuar nga Drejtoria e QS-së Klubin ose Subjektin që ka qenë i ngarkuar me përgjegjësi dhe ka shfrytëzuar Palestrën në kohën e shkaktimit të atyre dëmeve e ngarkojnë dhe e obligojnë që në afat prej 7 ditësh t'i kompensojnë ato.

9.3. Në rast të mos kompensimit të dëmeve siç parasheh neni IX pika 9.2 Përgjegjësi i Palestrës ,Klubit a Subjektit përgjegjës i ndalon aktivitetin në Palestër ndërsa QS përcjell procedurën në Institucionet gjyqësore .

Neni 10

10. Për shfrytëzimin e Palestrës së Sporteve , Klubet dhe subjektet tjera që kanë orar të rregullt të shfrytëzimit të këtij objekti , nënshkruajnë Kontrata me DRKS-në mbështetur në këtë Rregullore .

Neni 11

11. Ndryshimet dhe plotësimet eventuale të kësaj Rregulloreje bëhen sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes së saj.



Neni 12

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, pushojnë të vlejné dispozitat e rregullores për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestres së Sporteve"1 Tetori" të QS në Prishtinë, nr.297 të datës 18.11.2013.

Neni 13

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje kujdesen,Sektori për kulturë dhe Sektori për sport dhe rekreacion , ndërsa Drejtoria për strehim,kultur dhe sport e përcjell implementimin e saj.

Neni 14

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nenskrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i QS-së

Prishtinë, 29.03 2017

Drejtor i përgjithshëm:
Fatmir Sfishta

